

Abstrakti

“Ligjet me interes vital në Kosovë, problematikat dhe sfidat”

Mentor: Prof. Ass. Dr. Flamur Hyseni

Kandidati: Burim Ahmeti

Republika e Kosovës ka ndërtuar një sistem juridik të qëndrueshëm, të bazuar në praktikën më të mirë të sugjeruar edhe nga bashkësia ndërkombëtare dhe imponuar edhe nga procesi i negociatave që sollën deri tek pavarësia e vendit. Sistemi juridik ka krijuar një legjislacion që garanton të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës, duke pasur kështu një kushtetutë tejet të avancuar sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi, si dhe të drejtave dhe privilegjeve të komuniteteve jo shumicë në veçanti. Kosova ka krijuar një legjislacion të veçantë, të ashtu quajtur ligje me interes vital, të cilat përbëjnë një veçanti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Këto ligje kanë veçanti të tyre si për nga fushat të cilat ato i rregullojnë (normojnë), ashtu edhe për nga procedura që kërkohet për miratimin dhe ndryshimin e tyre. Këto ligje janë të karakterit kushtetues, dhe madje burojnë nga akte ndërkombëtare që i kanë paraprirë të drejtës së Kosovës për tu pavarësuar, përkatësisht krijuar shtetin e Republikës së Kosovës. Legjislacioni me interes vital prek fushat më të rëndësishme të rregullimit juridik, andaj procedura për miratimin, ndryshimin apo shfuqizimin e tyre parashihet me kushtetutë. Ky legjislacion është miratuar në pako pas pavarësimit të vendit dhe ka krijuar vështirësi të shumta në implementimin e këtyre ligjeve, ashtu që si pasojë e këtyre legjislacionit nuk i ka qëndruar kohës dhe nuk i është përshatur rrethanave të ndryshuara. Sfidat e shumta dhe problematikat që ka krijuar ky lloj i veçantë i legjislacionit në sistemin juridik të Republikës së Kosovës janë objekt i studimit të shkencave juridike kushtetuese, të cilat synojnë padyshim dhënien e zgjidhjeve dhe përgjigjeve adekuate ndaj këtyre çështjeve delikate të legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Fjalë kyçe: ligjet me interes vital, legjislacioni, kushtetutshmëria, procedura, sistemi juridik.